

Kryetari i Partisë Demokratike në Preshevë, Nagip Arifi, i cili njëherësh është edhe kryetar i Komunës së Bujanocit, ka deklaruar për agjencinë Fonet se shqiptarët janë të gatshëm për integrim në institucione të shtetit.

Por Arifi ka vlerësuar se ky proces po shkon "shumë ngadalë dhe që fare nuk ka përparim në këtë drejtim".

"Vitin e kaluar liderët politikë të shqiptarëve e kanë aprovuar vendimin e përbashkët të cilin e ka pranuar edhe Qeveria e Serbisë. Kemi pasur takime dhe me kryeministrin e atëhershëm Ivica Daçiç dhe me kryeministrin e tanishëm Aleksandar Vuçiq, dhe kjo bisedë është ndërprerë në shtator", e rikujton Arifi.

"Shqiptarët janë të gatshëm për integrim", ka theksuar Arifi, i cili konsideron që Qeveria e Serbisë, "fatkeqësisht, nuk është e gatshme që trajton edhe shqiptarët si shtetas i Serbisë".